

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BES

AKTIVITETE



U zhvillua më 29 dhe 30 mars 2023, mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme të Shkollës Ballkanike të Energjisë (BES) nën mikëpritjen e Entit Rregullator të Energjisë për Shqipërinë. Gjatë kësaj mbledhje, autoritetet rregullatore themeluese ku bëjnë pjesë Shqipëria, Bosnje - Hercegovina, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut, emëruan Z. Salvatore Lanza drejtor të shkollës për periudhën 2023-24. Gjatë aktivitetit u diskutua dhe u vendos mbi planin e punës për periudhën 2023 si dhe analizuan bashkarisht draft buxhetin e nevojshëm për arritjen e qëllimeve të bashkëvendosura nga Anëtarët si dhe bazat e rregullave të brendshme të shoqatës.

Aktivitetet e BES do të përqëndrohen kryesisht në zhvillimin e rrjeteve të energjisë elektrike dhe gazit; në integrimin e burimeve të rinovueshme; në lidhjen e tregjeve dhe në aktivitete të tjera që lidhen me tranzicionin energjetik dhe transferimin e njohurive ndërmjet Rregullatorëve. Asambleja pranoi në unanimitet po ashtu kërkesën e Rregullatorit të Greqisë RAE për tu bërë anëtar i BES dhe kërkesën e Rregullatorit të Serbisë AERS për të qënë vrojtues në këtë shoqatë.



Në datë 15 mars, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Konsumatorit, u organizua konferenca kombëtare “Varfëria Energjitike – Dialogu Politik”. Ky aktivitet u realizuar në kuadër të projektit EmpowerMed: “Fuqizimi i grave për të marrë veprime kundër varfërisë energjitike në Mesdhe” i cili adreson sfidën e varfërisë energjitike në zonën e Mesdheut, me fokus të veçantë në përfshirjen dhe fuqizimin e grave, në bashkëpunim me Milieukontakt Albania dhe Qendrën e Konsumatorit Shqipëtar. Qëllimi i takimit ishte advokimi për adresimin e politikave dhe masave për varfërinë energjitike tek aktorët kombëtarë dhe lokal. ERE u përfaqësua në këtë aktivitet nga Komisionerja znj. Erjola Sadushi, Sekretari i përgjithshëm, z. Elton Radheshi si dhe Drejtorja e Mbrojtjes së Konsumatorit, znj. Julia Guga. Në panelin e diskutimit se bashku me Komisionerin Kundër Diskriminimit, përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës



dhe Energjisë, Komisionerja e ERE, znj. Sadushi, vuri theksin në rëndësinë e madhe që ka jo vetëm angazhimi në rang institucional për të adresuar sfidat që varfëria energjitike paraqet si fenomen për Rregullatorin, por edhe vendosja e urave të bashkëpunimit e bashkërendimit të planit të veprimit mes aktorëve politikëbërës, rregullatorë si dhe ndërmjetës apo përfaqësues të intresave të konsumatorëve qofshin ata në nevojë apo në kushtet e varfërisë energjitike ose jo. Znj. Sadushi ju përgjigj pyetjeve të organizatorëve sa i përket kontributit të ERE në adresimin rregullator të çështjeve të kompetencës ligjore, siç janë miratimi i rregullave të posaçme të kushteve të ndërprerjes së furnizimit për klientët në nevojë, mbikëqyrja aktive e ofrimit të shërbimit të furnizimit për klientët në kushte të pamundësisë financiare apo që u varet cilësia e jetës nga pajisjet elektrike që furnizohen me energji, miratimi i rregullave të cilësisë së shërbimit të furnizimit.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

TEC

Gjatë mbledhjes së datës 27.03.2023 Bordi i ERE-s, pas konstatimit të pajisjes me lejet e nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, vendosi për licencimin e shoqërisë "KESH sh.a në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC i lundrueshëm i instaluar në Portin e Triportit në Gjirin e Vlorës i përbërë nga dy gjenerues: Tigr 1 me kapacitet të instaluar 50 MW, dhe Tigr 3 me kapacitet të instaluar 60 MW.

Kjo licencë është me afat 2 vjet nga data e komisionimit të impianteve.



Po këtë muaj, Bordi i ERE-s ka zhvilluar gjashtë mbledhje, të cilat kanë rezultuar në 54 vendimmarrje. Këto të fundit kanë rezultuar në licencimin e një subjekti në prodhimin e energjisë elektrike nga HEC, dy subjekteve në prodhimin e energjisë elektrike nga centrale fotovoltaike, dy subjekteve në tregtimin e energjisë elektrike si dhe miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shkurt 2023 prej 32.24 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, por dhe vendime mbi çështje të brendshme të organizimit të institucionit.

Gjithashtu, pjesë e axhendës mujore kanë qënë dhe seancat dëgjimore që lidhen me trajtimin e ankesave të konsumatorëve.

Për tu azhurnuar me informacion më të detajuar, shfletoni faqjen tonë zyrtare.

VENDIME

Në linkun e mëposhtëm gjeni miratimin e një ndryshimi në "Kodin e rrjetit TAP", të ndryshuar, miratuar nga Bordi i ERE-s sipas propozimit nga TAP AG më datë 13 mars 2023.

[Kliko këtu](#)

Gjatë muajit mars Bordi i ERE-s, pas verifikimeve të nevojshme, mbylli procedurën për heqjen e licencave të subjekteve debitoare për pagesat e rregullimit të vitit 2022, të pashlyera ndaj ERE-s.